

## Afrim (Fazli) Krasniqi

(5.10.1975, shqiptar nga Lladroviqi/Ladrović, komuna e Malishevës/Mališevo, student, pjesëtar i UÇK-së)

Afrimi ka qenë student i vitit të dytë të Fakultetit Ekonomik në Prishtinë/Priština. Në fillim të muajit korrik të vitit 1998, pas pjesëmarrjes në transportimin e armatimeve nga Shqipëria për në Kosovë, ai edhe zyrtarisht aderoi në radhët e shtabit të UÇK-së Kleçkë/Klečka. Ka rënë më **19.07.1998**, në betejë që me forcat serbe u zhvillua në **Rahovec/Orahovac**. Bashkëluftëtarët e kanë varrosur Afrimin te vendi i quajtur *Plepat e Rahovecit/Topole Orahovca* më 24.07.1998. Pas përfundimit të luftës, mbetjet e tij mortore u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Kleçkë/Klečka, më 19.09.2000.

**Burimet:** deklarata F.K, FDH-33497; KMDL NJ, *Buletini*, num. 9, tetor-dhjetor 1998, 121, FDH-23857; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; fotografi, FDH-18858; fotografi, FDH-21003.

## Hamdi (Sadri) Berisha

(3.02.1958, shqiptar nga fshati Carravranë/Crnovrana, komuna e Malishevës/Mališevo, arsimtar, katër fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Hamdiu ka qenë më i madhi në mesin e dymbëdhjetë vëllezërve dhe motrave. Pas mbarimit të studimeve të letërsisë shqipe në Universitetin e Prishtinës, ai u punësua si arsimtar në shkollën e mesme të **Rahovecit/Orahovac**. Ka qenë pjesëtar i shtabit lokal të UÇK-së. Në fillim, vetëm e mbante rojën, ndërkaq, më vonë, u bë komandant i një njësi të vogël. Kur njësitet e UÇK-së hyrën në Rahovec/Orahovac më 17.07.1998, Hamdiu iu përgjigj thirrjes së komandantit për mobilizim të jashtëzakonshëm të ushtrisë. Doli i armatosur nga shtëpia dhe ishte kjo hera e fundit që familjarët e shihnin të gjallë. Ka rënë në betejë me forcat serbe që u zhvillua më **19.07.1998**, në dalje të qytetit. Trupin e tij të pajetë e ka gjetur i vëllai Refkiu. Me ndihmën e bashkëluftëtarëve, Hamdiu e varrosën po atë ditë në varrezat e Carravranës/Crnovrana. Pas përfundimit të luftës, mbetjet mortore të Hamdiut u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve

të Luftës në Malishevë/Mališevo, më 10.06.2001.

**Burimet:** deklarata H.B, FDH-33498; KMDL NJ, *Buletini*, num. 9, tetor-dhjetor 1998, 121, FDH-23857; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

## Goran (Milorad) Tiosavljević

(17.09.1969, serb nga Balevci, komuna e Rashkës/Raška, një fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Gorani e kishte mbaruar shkollën e mesme turistike në Kralevë. Pastaj, e kreu trajnimin për oficer policie. Nga viti 1990, punonte në SPB-në e Prizrenit si pjesëtar i policisë rrugore. Në datën **19.07.1998**, rreth orës 17:30, ka gjetur vdekjen në betejë me forcat e UÇK-së, që u zhvillua te pika e karburanteve *Jaha Petrol*, në hyrje të **Rahovecit/Orahovac**.

**Burimet:** Gjykata e Qarkut Požarevac, K.77/99 (N. Mullaaliu dhe të tjerë), aktgjykimi, 12.11.2000, FDH-1915; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 70; SMIP, *Teroristički...*, III, 419, 935; KMKKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; *Pjesëtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme – viktimat e terrorizmit shqiptar në vitin 1998.*, <http://www.srbija-info.yu/vesti/1999-02/19/9769.html>, FDH-31078.

## Sakip (Mehmet) Bugari

(13.06.1943, shqiptar nga Rahovec/Orahovac, vozitës, katër fëmijë)

Sakipi ka punuar para luftës në ndërmarrjen *Piros* në **Rahovec/Orahovac**. Jetonte në bashkësi familjare me bashkëshorten dhe dy djemtë, një nga të cilët ishte i martuar dhe e kishte familjen e vet. Banonin në lagjen *Krstić* [në afërsi të stacionit policor]. Dy djemtë të tjerë të Sakipit punonin jashtë vendit. Në datën **19.07.1998**, luftimet në mes të forcave të UÇK-së dhe atyre serbe po zhvilloheshin në lagjen e tij dhe Sakipi me familje u strehuan në bodrumin e shtëpisë së Asllan Shehut. Në këtë bodrum, ishin strehuar atë ditë gjithsej afro 100 njerëzish. Nga ora 15:00, Sakipi me të rejën Hilmiyen u kthyen në shtëpi që të mernte pak ushqim. Në kthim, përderisa po kalonin pranë shtëpisë së Fadil Vuqitnës, Sakipin e qëlluan në shpinë me disa plumba. Ka